



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA


KOMUNA E SHTIMES

MUNICIPALITY OF SHTIME/ OPSTINA STIMLJE

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

/KANCELARIJA PRESEDNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E SHTIMES/OPSTINA STIMLJE	
Nr i Protokollit	02/870
Nr i Faqeve/Br. strana	3
Data/Danah	26.09.2024
SHTIME/STIMLJE	



ZYRA PËR INFORMIM/ INFORMATION OFFICE/ KANCELARIJA ZA INFORMISANJE

Procesverbal nga Dëgjimi Publik i Përgjithshëm me qytetarë të Komunës së Shtimes, mbajtur më 13 shtator 2024, në ora 18:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Shtimes

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryetari i Komunës së Shtimes, Qemajl Aliu, Drejtori i Shërbimeve Publike – Bardhyl Rushiti, Drejtori për Buxhet dhe Financa – Besnik Ahmeti, Drejtori i Administratës – Valon Januzi, Drejtori i Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emini si dhe Drejtoresha e Arsimit – Yllka Fejzullahu.

Kryetari merr fjalën dhe jep sqarime rreth Dëgjimit Buxhetor.

Qemajl Aliu: Përshëndetje për të gjithë ju të pranishëm, e veçanërisht për ju të nderuar qytetarë të komunës sonë që jeni sot këtu në këtë dëgjim publik të organizuar nga Komuna e Shtimes. Në kuadër të draftimit të hartimit të buxhetit vjetor të Komunës së Shtimes, i cili pritet të miratohet në javën e fundit të shtatorit, sot kemi thirrur dëgjimin publik me qytetarët e Komunës së Shtimes.

Sot bashkë me ne të pranishëm janë edhe Drejtorët, ku të pranishëm kemi Drejtorin e Financave, atë të Planifikimit Urban, kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorin e Shërbimeve Publike, Drejtoreshën e Arsimit. Prandaj çdo gjë që ju keni sot nevojë Drejtorët janë këtu për të na ndihmuar.

Më vonë do ta hapin debatin, ku ju qytetarë të nderuar do të mund ti adresoni shqetësimet dhe kërkesat e juaja, në mënyrë që ato të jenë të buxhetuara për vitin e ardhshëm.

Buxheti i Komunës së Shtimes për vitin 2025 është 10.7 milion euro, është një nga buxhetet më të mëdha që ka pas Komuna e Shtimes, në buxhetin lokal ose thënë në shifrat 870 mijë euro më shumë se sa viti paraprak. Megjithatë ne e dim që nevojat që ka Komuna e Shtimes ky buxhet

komunal është modest dhe normal i pamjaftueshem dhe nëse nuk do të ishin burimet tjera financiare që vijnë nga ministritë e linjes dhe organizatat e tjera buxhetore dmth ky buxhet nuk do të ishte zhvillimor, mirpo falë angazhimit tonë dhe falë dashamirsisë së ministrive dhe qeverisë, ne mund të ju themi hapur që po kaq para për secilin vit buxhetor po vijnë dhe po investohen në sferat e ndryshme në Komunë të Shtimes, për këtë jemi dëshmitarë gjithësecili prej nesh sidomos qytetarët aktiv sikur puna e juaj që dmth që jepni kontributin në vazhdimësi.

Prej këtyre 10.7 milion euro, diku 56 përqind ose 5.9 milion euro, shkojnë për paga dhe meditare. Ne e dim që Komuna e Shtimes, ka rreth 712 puntorë që e mbulojnë arsimin parashkollorë, fillor dhe të mesme, pastaj është shëndetësia, administrata dhe shërbimet publike, ku në total e bartin 56 përqind të buxhetit të Komunës së Shtime. Shpenzimet komunale janë 230 mijë euro, kategoria e subvencioneve dhe transfereve është 500 mijë euro si dhe shërbimeve kapitale 2.5 milion euro si dhe digasteri i mallrave dhe shërbimeve është 1.5 milion euro, nëse e analizojmë e shohim që në fund pagat dhe meditare janë para që shkojnë te pagat e punëtorëve dhe nuk është fare buxhet zhvillimor dhe mbetet dikund më pak se 4 milion euro që mbetet për investimet kapitale, për mallra dhe shërbime dhe për subvencione si dhe për këto që quhen shpenzime të kuvendit komunal.


Ndërsa tani ne jemi këtu për të hapur diskutimin dhe për të marr kërkesat e juaja si qytetarët të kësaj komune, andaj mos nguroni dhe tani fjala është për ju.

Kërkesat e banorëve :

- Agron Bafitu: Kam një kërkesë, tubimet të cilat po bëhen në sheshin “Ahmet Shtimja”, nëse ka mundësi të dërgohen te shkolla nalt.
- Artan Beqa: Lagjes ton në sheshin “Ahmet Shtimja”, nëse ka mundësi të hiqen barrierat tek fillimi i urës pasi që është bllokuar ura dhe nuk është e kalushme po ashtu nëse ka mundësi të bëhet një zgjidhje për banorët që jetojnë në shesh dhe bizneset, të bëhen një barrier që vetëm qytetarët të kenë qasje me qipa që te futen.
Po ashtu edhe ndërtimet e larta të lejohen që të bëhen do të ishte një favor I madh për ne.
- Bujar Beqa: Ndriçimi në shesh është ne mënyr katastrofale dhe po kemi probleme me konsumuesit e lëndëve narkotike, ne si banorë po kemi shumë probleme.
Herën e kalume e kemi ngritur si kërkesë kanalizimn dhe akoma nuk është zbatuar.
- Lulzim Balaj: Ne si fshat kemi një shqetësim për nxënësit, në fshatin Carralevë trotuaret janë shumë keq nëse ka mundësi të bëhet një zgjidhje sa më parë.
- Jusuf Xhema: Kemi nevoj për ndriçim 10 shpija ne lagjen “Ibrahim Rugova” dhe “Fehmi Agani”, gjithashtu edhe kanalizimin kemi problem arat të gjitha mbushen me ujë.
Po ashtu edhe një kërkesë, unë jam penzionist dhe tek Shoqata e Penzionistëve banjot janë bllokuar.
- Haki Bafiu: Ne si qytetarë po na pengojn fesimet të cilat po bëhen në shesh, prandaj nëse ka mundësi të zhvendosen në Kodër. Po ashtu të bëhen tualet publike tek sheshi dhe një pyetje kur do të bëhen ndërtimet e larta.



Posta tek parku nëse ka mundësi të kontrollohet apo të bëhet një zgjidhje pasi që të rinjët janë duke bërë katrahur në ato vende, mundësisht të pastrohet nga pastërtia.

Dëgjimi buxhetor ka përfunduar në ora 20:00











REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/



REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e nënshkrimeve

Data: 13.09.2024

Dëgjimi Publik me qytetarët

Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi
SAMIJE SHDIKI	
HAKI BAFTIU	
Bujar Bexir	
Baftiu AGRON BAFTIU	
BESNIK BAFTIU	
Artan Bexir	
Herolind Selmoni	
ARSIM RAMA	
Blerona Gashi	
Leonora Gashi	
VISAR TERSHANI	
Muharret Berisli	
Ridvan Fazlija	
Valon Hysenaj	



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/



REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e nënshkrimeve

Data: 13.09.2024

Dëgjimi Publik me qytetarët

Emri dhe Mbiemri

Nënshkrimi

[illegible]